FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

KLORAMFENIKOL

Tableta – 250 mg

(Kloramfenikol)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Kloramfenikol dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Kloramfenikol
3. Si ta merrni Kloramfenikol
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Kloramfenikol
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË KLORAMFENIKOL DHE PËRSE PËRDORET

Kloramfenikoli është një antibiotik bakteriostatik me spektër të gjerë veprimi.
Kloramfenikoli përthithet shpejt nga trakti intestinal, kurse biodisponibiliteti i tij është 75% deri në 90%. Përqëndrimi plazmatik maksimal është 10 deri në 200 mcg/mL. Rreth 60% e kloramfenikolit lidhet me proteinat plazmatike.
Kloramfenikoli hyn në lëngun trunoshpinor, madje edhe në mungesë të meningjeve të inflamuara. Jashtëqitja e përgjithshme urinare e kloramfenikolit luhatet nga 68% deri në 99% për tri ditë. Pjesa më e madhe e kloramfenikolit të pranishëm në gjak është në formën aktive. Gjysmëjeta e eliminimit të kloramfenikolit është rreth 4 orë.
Kloramfenikol tabletë përdoret në infeksione kërcënuese për jetën, kryesisht ato të shkaktuar nga Haemophilus influenzae, dhe në ethet tifoide. Kloramfenikol nuk duhet të përdoret nëse ekzistojnë barna të tjera alternative më të sigurta.

2. PËRPARA SE TË MERRNI KLORAMFENIKOL

Mos merrni Kloramfenikol në qoftë se:

- jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj kloramfenikolit ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të tabletave Kloramfenikol;
- keni infeksione të lehta;
- keni dëmtim të rëndë të funksionit të veshkave;
- keni insufiçiencë të rëndë renale;
- keni dëmtim të funksionit të mëlçisë;
- jeni në periudhën e shtatzënisë dhe ushqimit me gji të fëmijës;
- keni deprimim të palcës së kockës dhe diskrazi gjaku;
- jeni duke përdorur barna që deprimojnë funksionin e palcës së kockës;
- keni porfiri.

Kloramfenikoli kundërindikohet në fëmijët e porsalindur për shkak se shkakton "sindromën gri".

Tregoni kujdes të veçantë me Kloramfenikol
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Kloramfenikol.
Kloramfenikol duhet përdorur me kujdes tek të sëmurët me dëmtim të funksionit të veshkave.
Kloramfenikoli mund të ulë efektet hematologjike të vitaminës B12 dhe përgatesave të hekurit tek të sëmurët me anemi pernicioze ose me mungesë hekuri; për këtë arsye ato nuk duhen përdorur njëkohësisht.
Gjatë përdorimit të Kloramfenikol kështillohet të bëhen kontrolle periodike të formulës së gjakut.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Kloramfenikol. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Kloramfenikol në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Kloramfenikoli çaktivizohet në mëlçi dhe prandaj ai mund të ndërveprojë me barnat që metabolohen nga enzimat mikrozomale të mëlçisë.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- hidantoina, sepse Kloramfenikol mund të rrisë nivelet e tyre në serum;
- kontraceptivë oralë, sepse kloramfenikoli mund të ulë efektin e tyre;
- vitaminë B12 dhe përgatesat e hekurit, sepse kloramfenikoli mund të ulë efektin e tyre;
- antikoagulantë oralë, sepse Kloramfenikol mund të rrisë efektin e tyre;
- rifampicinë, sepse mund të ulë nivelet plazmatike të kloramfenikolit;
- antidiabetikë, sepse kloramfenikoli thekson efektet e sulfonilureikëve;
- klozapinë;
- ciklosporinë;
- klopidogrel;
- takrolimus;
- barbiturate, sepse ulin efektshmërinë e kloramfenikolit.

Shtatzënia
Kërkoni kështillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.
Kështillohet mospërdorimi i Kloramfenikol gjatë shtatzënisë, sidomos gjatë tremujorit të fundit të saj për shkak të shfaqjes së "sindromës gri" në të sapolindurit.

Ushqimi me gji
Kloramfenikol kalon në qumështin e gjirit dhe prandaj nuk duhet të përdoret gjatë ushqimit të foshnjes me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Kloramfenikol mund të shkaktojë çrregullim të sistemit nervor qendror (dhimbje koke, konfuzion, delir, depresion të lehtë dhe çrregullime të shikimit), gjë që mund të dëmtojë aftësinë për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri.

3. SI TA MERRNI KLORAMFENIKOL

Gjithmonë merreni Kloramfenikol sipas kështillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Kloramfenikol janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Tabletat duhet të gëlltiten me të paktën gjysmë gote ujë.
Doza e zakonshme është 1 - 2 g, që jepet në 4 doza të barabarta (çdo 6 orë), në varësi nga rëndësia e infeksionit. Mjekimi duhet vazhduar të paktën 24 - 48 orë pasi simptomat të jenë zhdukur. Kloramfenikol, duhet përdorur 1 orë para ose 2 orë pas ushqimit, me shumë lëngje.

Kloramfenikol nuk duhet të merret për një kohë të gjatë apo në mënyrë të përsëritur.
Përdorimi në fëmijë duhet të arsyetohet nga mjeku. Mjeku juaj do t'ju kështillojë në përputhje me rrethanat.

Në qoftë se keni marrë më shumë Kloramfenikol
Në qoftë se keni marrë më shumë Kloramfenikol se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe kështillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Kloramfenikol
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Kloramfenikol mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Efektet e padëshirueshme më të shpeshta janë:

- efekte hematologjike (deprimim i palcës së kockave, anemi aplastike, hemoglobinuri nokturne, anemi hipoplastike, trombocitopeni);
- efekte në sistemin nervor qendror (dhimbje koke, konfuzion mendor, delir, depresion i lehtë, neurit optik, neurit periferik);
- në aparatin tretës (diarre, të përziera, të vjella, glosit, stomatit);
- "sindromi gri" (shfaqet me shqetësime abdominale, të vjella, ngjyrë të hirtë, hipotermi, frymëmarrje të çrregullt, cianozë të zbehtë progresive dhe kolaps cirkulator e pas disa orësh i sëmuri mund të vdesë).

Janë konstatuar edhe reaksione mbindjeshmërie (p.sh.: ethe, ekzantema, angioedema, urtikarie, anafilaksi).
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI KLORAMFENIKOL

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Kloramfenikol pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Ruajeni nën temperaturën 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Kloramfenikol 250 mg - tabletë
Lënda vepruese është kloramfenikoli.
Çdo tabletë përmban 250 mg kloramfenikol.
Përbërësit e tjerë janë: amidon, celulozë mikrokristalore, xhelatinë, glikolat natriumi i amidonit dhe stearat magnezi.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 30 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.

Nuk mund të merret gjatë shtatzanisë.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe Prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.:00 355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Korrik 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.